

VENDIM
Nr. 39, datë 1.6.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KONISPOL

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe të rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. 18 prot., të datës 6.3.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol është themeluar në datën 20.8.2017, si shoqëri aksionare me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Konispol, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 29.12.2018, me NUIS: L74829801V.

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol. Dosja u plotësua në datën 28.5.2018.

- Objekt i aktivitetit në ekstraktin e QKB-së është vetëm shërbimi i furnizimit me ujë dhe dokumentacioni mbi asetet e shoqërisë tregon se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka në zotërim vetëm asetet e sistemeve të furnizimit me ujë edhe pse emrin shoqëria e ka ujësjiellës-kanalizime.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit mbi licencimin për herë të parë vetëm për shërbimin e furnizimit me ujë, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a., me:
Drejtues ligjor dhe drejtues teknik: Lefter Ballabani
 2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
 3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Konispol.
 4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani